



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 2. 5. 2019, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Ganimete Musliu, Lutfi Zharku, Salih Salihu, Andin Hoti, Salih Zyba dhe Danush Ademi.

Munguan: Liburn Aliu, Etem Arifi dhe Sergjan Mitroviç.

Të ftuar: Fatmir Matoshi, ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Arben Çitaku, sekretar i përgjithshëm; Gani Berisha, u.d. drejtor i Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore; Sevdije Lama, Leutrim Sahiti dhe Valon Maliqi, këshilltarë.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 18.4.2019;
3. Raportimi i z. Fatmir Matoshi, ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me hidrocentralet dhe problemet tjera mjedisore;
4. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës, e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se komisioni, me 7 vota për, miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 18.4.2019

Kryetari konstatoi se komisioni, me 8 vota për, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.4.2019.

3. Raportimi i z. Fatmir Matoshi, ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me hidrocentralet dhe problemet tjera mjedisore

Kryetari Nitaj, fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi për pjesëmarrje z. Fatmir Matoshin, ministër i MMPH-së (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) dhe kërkoi nga ai vazhdimin e raportimit, lidhur me temën e hidrocentraleve (HC), të filluar në një mbledhje të kaluar, por përveç kësaj, ai kërkoi që të sqarojë edhe çështjen e vendosjes së laurave, në hyrje të Grykës së Rugovës, e cila ka shkaktuar reagimin qytetar dhe disa probleme me Erenikun, në Komunën e Junikut.

Fatmir Matoshi, ministër, në fillim tha se gjendja nuk është e kënaqshme, sa i përket hidrocentraleve, sepse edhe sot nuk ka një vlerësim të mirëfilltë të kapaciteteve ujore për HC dhe përmendi një vlerësim nga ish-Ministria e Energjisë, në vitin 2009 dhe potencoi se asnjë hidrocentral në Kosovë nuk ka leje mjedisore dhe për MMPH-në, asnjëri prej tyre nuk është legal.

Ka shumë kërkesa për shqyrtim dhe për momentin jemi në një moratorium, sa i përket kësaj sfere. Ka shumë investitorë që kanë marrë pëlqime mjedisore, leje ujore ose leje ndërtimore, por asnjëri nga ta nuk është pajisur me leje mjedisore, i cili është dokumenti i fundit që e lëshon MMPH, para se të fillojë një operator punën në mënyrë legale dhe të rregullt. Mirëpo, ai sqaroi se nuk është MMPH i vetmi institucion që merret me këtë çështje, por është një radhë e procedurave, derisa një operator të bëjë funksional HC. Në MMPH asnjë kërkesë nuk është trajtuar pa pëlqimin e komunës ku ndodh investimi. Për këtë arsye, në takimet me kryetarët e komunave, tha se ka kërkuar që të jenë të vëmendshëm, kur japim pëlqimin për ndërtimin e HC, pasi që ata shpesh nuk po i konsultojnë sa duhet banorët dhe pastaj po pendohen. Pas kësaj, kërkohet pëlqimi preliminar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe pastaj ata vijnë në MMPH për t'u pajisur me leje përkatëse. Për këtë takim, tha se kishte qenë mirë të ishte edhe ZRRE, sepse ata janë rregullator, ndërsa MMPH nuk është autoriteti që ndalon. Ka disa HC që punojnë në fazën testuese dhe nuk aplikojnë për leje mjedisore, ku deri tash ka pasur vetëm një kërkesë për pajisje me leje mjedisore.

Më pas foli edhe lidhur me vendosjen e laurës në Grykën e Rugovës. Lidhur me këtë, tha se Kuvendi i Kosovës, me ligj, i ka shpallur dy parqe nacionale dhe kompetencat për menaxhim ia ka dhënë MMPH-së. Në kuadër të përgjegjësive, kemi vendosur të kontrollohen hyrje-daljet në parqe, me qëllim të parandalimit të prerjes ilegale të drunjve, ndërtimeve pa leje dhe ndalimin e gjuetisë ilegale. Për këtë janë siguruar banorët që kanë pronë në atë zonë se nuk janë të obliguar të paguajnë. Ndërsa në të ardhmen ndoshta vizitorët do të paguajnë dhe këto mjete do të shkojnë në mirëmbajtjen e këtyre parqeve.

Në Junik, bëhet fjalë për një burim në territorin e Komunës së Gjakovës, që i është dhënë leje ujore KRU "Gjakova" për shfrytëzim për ujë të pijes për 28 fshatra të kësaj komune. Kjo ka shkaktuar reagim nga Komuna e Junikut, megjithatë Ligji për ujërat është i qartë, se uji i pijes është prioritet në krahasim me të gjitha qëllimet tjera të shfrytëzimit të tij.

Besa Gaxherri, fillimisht tha se ambienti është i rënduar, si pasojë e neglizhencës së problemit, për arsye të ndryshme, që nga paslufta dhe çështja e ambientit përcillen me kosto të lartë financiare.

Ne e kemi qymyrin një aset të rëndësishëm, që ambientalistët e kundërshtojnë dhe i dimë pasojat e përdorimit të tij, mirëpo jemi shteti me më pak ujë në rajon. Nga raporti shihet se 7 HC janë aktive, ndërsa në procedurë janë 63 dhe se ndihet e befusuar sesi nuk ka asnjë leje mjedisore për hidrocentrale. Prandaj shtoi se në një shtet siç është Kosova, me kaq pak ujë, na japin të kuptojmë se ka krim të organizuar me këto hidrocentrale, edhe pse prokuroria dhe gjykatat se kanë dëshmuar. Këtu përmendi rastin e HC në Grykën e Deçanit, i cili e ka shkatërruar ambientin tërësisht dhe e arsyetoi protestën e banorëve të Rugovës, kundër ndërtimit të HC në Lumbardh.

Pastaj pyeti ministrin: Çka ka ndërmarrë MMPH për HC në Grykën e Deçanit, a është ngritur procedurë ligjore ndaj tij? A ju ka dhënë përgjigjja kompanisë investuese se nuk mund të vazhdojë punën në Lumbardh të Pejës? Për HC-të, që janë në funksion dhe nuk kanë leje mjedisore, çka ka ndërmarrë MMPH-ja, pse nuk e ndalon punën e tyre? Ndërsa, në fund, për laurat tha se MMPH nuk i ka informuar sa duhet qytetarët, për aspektet përfituese të tyre.

Andin Hoti, duke u ndërlidhur me fjalën e ministrit se të gjitha HC në Kosovë janë ilegale, pyeti: Pse nuk mbyllen ato dhe nëse kjo nuk varet vetëm nga MMPH, si është mundësia të ndalën ato? Kush është përgjegjës dhe çka ka ndërmarrë ministria që të bëhet një vlerësim i mirëfilltë i kapaciteteve ujore? Në fund, duke potencuar se për t'u pajisur me një leje për HC, duhet që për të kërkuar leje të ndryshme të frekuentohen 14 institucione të ndryshme. Pyeti: A keni ndërmarrë diçka që kjo burokraci të thjeshtohet?

Salih Zyba, duke e falënderuar ministrin për gatishmërinë për të raportuar, sugjeroi që agjenda e ministrit mos të ndikojë në ndryshimin e agjendës së komisionit. Më pas, për raportin e dërguar nga MMPH për HC-të, tha se është i pakët për nga vëllimi. Ai u pajtua me vlerësimet dhe konstatimet se gjendja nuk është e mirë sa i përket HC-ve dhe asnjë nuk ka marrë leje mjedisore, dhe pyeti: Pasi që disa prej këtyre HC-ve kanë 2 vjet që testohen, sa kohë duhet që ata të bëjnë teste për shfrytëzim të resurseve natyrore? Pastaj pyeti për ndërtimin e HC në parqe dhe zona të mbrojtura. Ndërsa, për HC-në e Ujmanit, pyeti lidhur me investimet që thuhet se i ka bërë Serbia. A është dashur që këto investime të kalojnë përmes procedurave të ministrisë apo është shpërfillur?

Më tej, **Salih Salihu** theksoi se uji për fat të keq shumë pak shfrytëzohet për pije, ujitje dhe energji dhe ai duhet të shfrytëzohet sipas standardeve të qëndrueshme, duke mos dëmtuar ambientin. Për HC-të, që nuk kanë leje mjedisore, pyeti: Ku është problemi që ata nuk pajisen me të, ndërsa ata vazhdojnë punën edhe pa të dhe shkaktojnë dëme në ambient? Pse këto HC që s'kanë leje mjedisore ende punojnë? Pastaj tha se, Kosova ka shumë pak ujë dhe ka lumenjtë që burojnë dhe rrjedhin pa u shfrytëzuar, si p.sh. lumi Morava e Binçës, Lepenci, etj. dhe nuk ka një plan afatgjatë si të bëhet akumulimi i ujërave për pije, ujitje dhe energji. Lumi Morava e Binçës, në pjesën e epërme të Shusht-Viti, gjatë dimrit i ka 5 000 litra në sekondë, ndërsa gjatë verës 1200 l/s dhe nuk shfrytëzohet ky potencial. Ndërsa, në lidhje me këtë, kërkoi nga ministri propozime të qarta për akumulimet e reja të ujit.

Ganimete Musliu, e falënderoi ministrin dhe tha se është shumë përgjegjës dhe bashkëpunues me komisionin për trajtimin e këtyre problemeve. Duke u ndërlidhur me konstatimin e ministrit, se asnjë HC nuk ka leje mjedisore, pyeti: A kanë pasur ndonjëherë këto HC leje mjedisore? Dhe nëse punojnë pa leje mjedisore, çka ka ndërmarrë konkretisht ministria, për ndërprerjen e punës së tyre?

Lutfi Zharku, në lidhje me 63 HC, që janë në procedurë, sipas raportit, pyeti: Sa prej tyre janë në investim e sipër, sa s'kanë filluar investimet dhe sa prej tyre iu ka skaduar pëlqimi e nuk kanë filluar punën? Si element me rëndësi, ai përmendi se prej vitit 2016, nuk ka pëlqime të reja mjedisore dhe pyeti për shkakun e kësaj: A është ndërrimi i politikave qeveritare, apo nuk ka hapësirë për pëlqime të reja mjedisore, a po u krijohet monopol atyre që kanë leje?

Ministri Matoshi iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Për procedurën e lejes mjedisore për HC, hapi i parë është pëlqimi i komunës, hapi i dytë autorizimi preliminar i ZRRE-së, hapi i tretë pëlqimi mjedisor, ndërsa hapi i nëntë është leja mjedisore. Për dallimin mes pëlqimit dhe lejes mjedisore, për pëlqimin mjedisor janë kushtet mjedisore që investitori duhet t'i përmbushë në fund të projektit dhe e kthen ambientin në gjendjen e mëparshme. Ata në fillim marrin pëlqim mjedisor, pastaj leje ujore, leje ndërtimore dhe e ndërtojnë objektin dhe është faza testuese e objektit dhe pastaj duhet të rikthehet ambienti në gjendje të mëparshme, dhe pas kësaj, ata aplikojnë për leje mjedisore. Pastaj komisioni e vlerëson gjendjen në terren, nëse ai mund të pajiset apo jo me leje mjedisore.

Ndërsa për procedurat e lejes për HC dhe nevojën për shumë dokumente, tha se ashtu është e përcaktuar me ligje dhe janë të involvuara disa institucione: komuna, ZRRE, KEDS, MMPH, Agjencia e pyjeve, Ministria e Kulturës, etj.

Për operatorët që nuk kanë leje mjedisore, është njoftuar ZRRE, përmes një shkrese, prandaj është obligim i ZRRE-së t'i ndalë prej operimit, dhe sa kemi informacion në Deçan, ia ka ndërprerë operimin njërit operator, sepse ka 3 apo 4 vjet që ai operon në emër të fazës testuese. Periudha testuese e operimit, të cilin e përcakton ZRRE-ja, është 6 muaj.

Inspektorati i MMPH-së, më 19 korrik 2016, ka dalë në terren tek operatori në Deçan dhe ka vërejtur se ai nuk i ka plotësuar kushtet e lejes ujore, pastaj i ka dhënë 30 ditë afat për përmirësim. Pra, edhe pas kësaj nuk janë përmirësuar dhe lënda është dërguar në gjykatë dhe deri më sot nuk ka ndonjë përgjigje. Për këtë i kemi shkruar ZRRE-së dhe presim nga ai operator t'i kryejë obligimet, konform kushteve mjedisore dhe projektit që e ka dorëzuar në MMPH, kur është pajisur me pëlqim mjedisor.

Për Lumbardhin e Pejës nuk ka asnjë kërkesë për asnjë lloj leje, deri më sot, në MMPH. Ndërsa, protesta që është bërë në Pejë është dashur të bëhet në vitin 2012, atëherë kur kuvendi komunal e ka dhënë pëlqimin, dhe me sa di unë, tha nuk është pezulluar ai pëlqim. Ndërsa, kam kërkuar nga kryetari i Pejës, që të marrë vendim për shfuqizimin e këtij vendimi.

Për laurat në parqe, ka pasur komunikim dhe banorët janë njoftuar, mirëpo jemi të gatshëm të vazhdojmë komunikimin dhe ne do të mundohemi që t'i mbrojmë parqet nacionale.

HC i Ujmanit, posedon leje mjedisore që nga koha e paraluftës dhe ata aplikojnë për leje ujore, por që s'kanë aplikuar deri më sot, ndërsa tha se nuk kemi informacion për investimet.

Për rezervat e pakta të ujit dhe lumenjtë që dalin me shpejtësi jashtë territorit të Kosovës, tha se është shqetësuese, pse nuk është bërë ndonjë investim për diga. Është bërë kërkesë Bankës Botërore, vitin e kaluar, dhe kemi marrë përgjigje pozitive. Jemi në procedurë të negociatave për financimin e disa rezervuarëve të ujit dhe një prej tyre është ai te Shusht/Viti, Lepenc, Drenas, Kamenicë, etj. Po ashtu, ai beson se Banka Botërore, me 50 milionë euro, do ta mbështesë ndërtimin e këtyre akumulimeve, gjithashtu edhe Komisioni Evropian, me 10 milion euro, do të participojë, por edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Këto projekte janë edhe në strategji të ujërave dhe jemi duke kërkuar fonde për to, ndërsa në vitin 2020 shpresojmë se do të fillojë ndërtimi i akumulimit të parë në Kamenicë, me investime të Bankës Botërore.

HC-të s'kanë pasur leje mjedisore kurrë më parë dhe ajo merret vetëm një herë. Në vazhdim, paraqiti një kronologji për 63 HC, që janë në procedurë: 7 prej tyre kanë leje ujore dhe janë aktivë, 12 kanë leje ujore dhe nuk janë aktivë, 36 kanë kushte ujore (para lejes ujore), 2 janë në procedurë pa kushte ujore dhe 11 kanë pëlqime ujore.

Duhet të bëhet një vlerësim më i gjerë i kapaciteteve ujore dhe përmendi se nga uji i lumenjve që dalin në Shqipëri, funksionojnë shumë HC. Pastaj **Arben Çitaku**, sqaroi se është një studim i vitit 2009, i realizuar nga ish- Ministria e Energjisë, por i cili nuk është formalizuar në formën e miratimit, mirëpo si i tillë përbën bazë për shqyrtimin dhe lëshimin e këtyre lejeve. Aty janë përcaktuar lokacionet dhe potencialet për HC-të. Problemi qëndron se autorizimet që janë prej ZRRE-së për energjinë e ripërtëritshme për hidrocentrale, përbëjnë obligime institucionale për shtetin e Kosovës. ZRRE e ka një kapacitet për HC, varësisht prej kërkesave të operatorëve dhe investitorëve, i aprovon dhe pastaj ata iu nënshtrohen procedurave të mëtejme administrative.

Besa Gaxherri, sugjeroi që të rishikohet kjo strategji e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, sepse Kosova nuk ka kapacitete ujore të mjaftueshme për 70 HC, dhe duke e ditur edhe presionin e BE-së për 20% të energjisë së rinovueshme, pyeti: A është bërë ndonjë analizë e bazuar në argumente se Kosova nuk ka kapacitete për 70 HC dhe së paku të bëhet një moratorium deri të ngrihen digat e mjaftueshme?

Arben Çitaku, tha se është bërë një analizë komplete e procedurave ligjore dhe janë disa ligje që e rregullojnë këtë fushë: Ligji i ZRRE-së, energjisë, ujërave, ndërtimit, mjedisit, etj., që e lejojnë nën kushte të caktuara të operojë një HC dhe moratoriumin të cilin MMPH e ka vendosur prej vitit 2016, në shqyrtimin e aplikacioneve na paraqet problem, sepse nuk jemi në harmoni të plotë me ligjin dhe për këtë kemi edhe vendime të gjykatave.

Ministri, në vazhdim, theksoi se në bazë të studimit të ish- Ministrisë së Energjisë më 2006-2009, ekziston një listë, ku janë të përcaktuara saktë lokacionet e mundshme për ndërtimin e hidrocentraleve. Në kuadër të kësaj liste, vetëm në Lumbardh të Pejës janë tre vende potenciale, të vlerësuara për ndërtimin e mundshëm të HC. Tash nuk jemi duke shqyrtuar asnjë kërkesë dhe

krejt kjo është për shkak të një e-maili të ish- ministres, të dërguar në prill 2018, administratës dhe sekretarit të MMPH-së. Ky nuk është vendim apo urdhëresë, por është në kërkesë, në të cilën thuhet se, derisa të marrim sqarim nga Zyra Ligjore e Kryeministrit, por nuk kam njoftim se ajo ka shkuar për interpretim atje. Dikush prej investitorëve ka pasur një pjesë të lejeve, kanë filluar investimet, për dy raste jemi paditur, si MMPH në gjykatë, pse nuk po i shqyrtojmë kërkesat e tyre.

Salih Zyba, tha se duke pasur shqetësimin që ka ndodhur me resurset për energjinë e ripërtëritshme, në procedurë gjyqësore janë 4 ish- ministra për 4 HC. Ndërsa, pyeti: Pse ka ndodhur ndërprerja e shqyrtimeve të kërkesave? MMPH duhet t'i shqyrtojë qoftë edhe t'i refuzojë dhe mundësia e keqpërdorimit është edhe mosshqyrtimi. Pastaj citoi një raport të një organizate për HC: "Tani në Kosovë, sipas KOSTT-it, janë 13 hidrocentrale". Lidhur me këtë, pyeti: A është kjo në përputhje me të dhënat që i ka MMPH? Në vazhdim, tha se ka edhe komuna që i kundërshtojnë këto projekte dhe konstatoi se jo çdo komunë e mirëpret si investim. Ndërsa, në fund pyeti sekretarin për studimin e vitit 2009: Kush do të duhej ta miratonte atë?

Ministri theksoi se nuk e di se cilat komuna i refuzojnë kërkesat për investime, por ne ballafaqohemi vetëm me kërkesat e miratuara prej komunës, e cila është e drejtë ekskluzive e tyre. Ndërsa, **Arben Çitaku** tregoi numrin e pëlqimeve të dhëna për HC, sipas komunave: Dragashi 17, Prizreni 15, Gjakova 3, Peja 2, Mitrovica 6, Podujeva 2, Viti 4, Deçani 1, Istogu 1, Kaçaniku 6. Prandaj, ne jemi të obliguar t'i shqyrtojmë këto kërkesa, duke respektuar ligjin, por jo të ndalen në mënyrë arbitrare dhe kjo ka ndodhur pikërisht si rezultat i këtyre protestave të iniciuara nga kuvendet komunale. Sipas tij, paradoksi është se një kryetar komune e nënshkruan këtë pëlqim dhe pastaj proteston bashkë me qytetarët. Ndërsa, në lidhje me raportin, tha se ne e kemi ofruar një raport që ka qenë bazë për diskutim sot, ndërsa për studimin e vitit 2009, ai është dashur të miratohet nga Qeveria.

Ministri, në fund, edhe njëherë shprehu gatishmërinë për bashkëpunim, ndërsa sa i përket vizitave të përbashkëta në terren, tha se janë të mirëseardhura dhe këto vetëm e fuqizojnë autoritetin e ministrit dhe MMPH-në. Në fund, tha se këshilltarja Sevdije Lama është e caktuar të kontaktojë me komisionin dhe administratën, dhe për çdo kërkesë dhe shqetësim, ne ju presim në MMPH, për të diskutuar për këto tema.

Në përfundim të kësaj pike të rendit të ditës, u paraqitën dy propozime:

Besa Gaxherri, propozoi që për hidrocentralet, komisioni të dalë me një konkludim dhe të kërkojë nga ministria një dokument apo strategji, me argumente nga ekspertët e kësaj fushe, që Kosova duhet ta rishikojë strategjinë e hidrocentraleve, pasi që i ka 70 HC të parashikuara, por Kosova nuk ka kapacitete ujore. Kishte qenë mirë që edhe komisionet adekuate të jenë në ujdi, por ne mund ta bëjmë nga fusha e mjedisit, për shkak të shkatërrimit të ambientit, pastaj mund të kërkojmë edhe nga ministrinë tjera. Edhe BE-së duhet argumentuar, se nuk mund të kërkojë nga Kosova me këto kushte që ka, 20 % të energjisë së ripërtëritshme. Pra, njëherë të bëhet moratorium, derisa të ngrihen digat e mjaftueshme dhe pastaj edhe një përqindje duhet plotësuar me energjinë alternative të pastër: me erë, solare etj. Në fund, tha se nëse e pranon komisioni këtë propozim, atëherë duhet të formulohet saktë kjo kërkesë.

Kryetari u dakordua me propozimin, por tha se nuk është MMPH adekuate, pasi që ata japin vetëm lejen mjedisore, ndërsa këtë mund ta kërkojmë nga ZRRE dhe MZHE, por të flasim me ministrin, me qëllim që ta adresojmë saktë këtë kërkesë.

Ndërsa, **Salih Salihu**, tha se është e paraparë me ligj, që 50% e ujit të shfrytëzohet për HC, ndërsa investitorët, për të krijuar më shumë energji, marrin më shumë sasi, por edhe tërë ujin dhe pastaj mbetet shtrati i lumit pa ujë. Prandaj, propozoi që komisioni ose kryetari, në emër të komisionit, ta ngre si çështje për diskutim në Kuvend, pasi që kjo është shumë shqetësuese. P.sh. në lumin Morava e Binçës në Viti, katër kërkesa për HC, kanë marrë pëlqim nga komuna. Në këtë mënyrë, duhet t'u bëhet e ditur edhe kryetarëve të komunave, të mos nguten, kur të japin pëlqimet.

4. Të ndryshme

Salih Zyba, paraqiti një draft-agjendë, e kërkuar në mbledhjen e fundit, për vizita në terren për monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe pyeti se nëse dikush ka ndonjë propozim konkret për plotësimin e saj. Pastaj kryetari konstatoi se komisioni miratoi, në parim, këtë agjendë dhe kjo i dërgohet MMPH-së për harmonizim, pasi që duhet të jetë në bashkëpunim me MMPH-në, në lidhje me vizitat në terren.

Kryetari, për agjendën e projektligjeve në komision, kërkoi nga kryesuesit që të vazhdojë puna e katër grupeve të punës, të formuara për projektligje: për Projektligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; për Projektligjin për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës; për Projektligjin për produktet biocide dhe për Projektligjin për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve, në fushën e ndërtimit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Muharrem Nitaj